

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I PËR APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-145/11

Prishtinë 24 gusht 2012

Në çështjen e:

H.H.,

Pala përgjegjëse në kërkesë/Pala ankuese

Kundër

I.Đ.

Paraqitësi i kërkesës/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e kolegjit, Elka Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Anëtar të kolegjit, duke vendosur me ankesën e paraqitur ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/76/2010 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA39215), të datës 16 qershor 2010, pas shqyrtimit të mbajtur me 24 gusht 2012, morri këtë:

AKTGJYKIM

- 1- Anulohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/76/2010, i datës 16 qershor 2010, për sa i përket lëndës së regjistruar me numër KPA39215 dhe kërkesa hudhet poshtë për shkak se nuk bie nën jurisdiksionin e KKPK-ës.
- 2- Obligohet pala përgjegjëse në ankesë që t'i paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej € 60 (gjashtëdhjetë) brenda afatit prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbartimit të detyrueshëm.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Me 15 tetor 2007, I.D. në cilësinë e anëtarit të familjes ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) ku kërkonte që gjyshi i tij B.D. të njihej si pronar i ngastrës kadastrale nr.614/1 në vendin e quajtur "obrandja për mbi lum", në sipërfaqe prej 0.45.41 ha, të zonës kadastrale Peran. Ai pretendon se posedimi për këtë paluajshmëri është humbur me 16 qershor 1999, si rezultat i rrethanave në Kosovë në vitin 1998/1999. Ai kërkon të drejtën e konfirmimit të pronësisë dhe riposedimin. Kërkesa është regjistruar nën Nr. KPA39215.

Për të mbështetur kërkesën e tij, paraqitësi i kërkesë ka paraqitur në AKP këtë dokumentacion, dhe atë:

- Fletën poseduese Nr. 11, lëshuar nga Shërbimi Kadastral i Komunës së Podujevës, me 21 gusht 2001;
- Aktvendimin e Gjykatës Komonale në Kurshumli T. Nr.3/2008, i datë 16 prill 2008;
- Certifikatën e vdekjes për B.D., të datës 25 prill 2006, të lëshuar nga qyteti i Nishit.

AKP-ja i kishte njoftuar palët e interesuara për kërkesën e paraqitur me datë 16 prill 2010. Njoftimi ishte kontrolluar bazuar në koordinatat GPS, hartën kadastrale dhe ortofoto dhe është gjetur si i rregullt.

A.h. ishte përgjegjur kërkesës së parashtruar, duke vepruar në emër të babait të tij. Ai ka theksuar se sipas kontratës së datës 3 shkurt 2009, e vërtetuar pranë Gjykatës Komunale në Podujevë Vr.nr.164/09, prona e kontestuar ishte blerë nga babai i tij R.A.K.. R.A.K. kishte blerë këtë palujtshmëri nga shitësit e mëparshëm M.G., R.D. dhe Z.D., sipas kontratës së shitjes të vërtetuar para Gjykatës Komunale në Podujevë Vr.Nr. 2151/2008, datë 23 dhjetor 2008. Në mbështetje të kërkesës së tij, ai kishte paraqitur prova relevante.

Me vendimin e tij KPCC/D/A/76/2010, të nxjerrë me 16 qershor 2010, KKPK-ja ka vendosur në të mirë të paraqitësit të kërkesës.

Paraqitësi i kërkesës ka pranuar vendimin e KKPK-ës me datë 9 mars 2011.

Palës përgjegjëse në kërkesë i është dorëzuar vendimi i KKPK-ës me datë 15 korrik 2011.

Pala përgjegjëse në kërkesë, H.H. (tani e tutje: ankuesi) ka ushtruar ankesë në Gjykatën Supreme me datë 15 gusht 2011, kundër vendimit-të sipërcekur.

Në ankesën e tij ai pretendon se vendimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të LPK-ës, aplikim jo të drejtë të ligjit, duke theksuar se ai ka paraqitur prova ligjore valide në AKP për fitimin e të drejtës së pronësisë në pronën e palujtshme, siq është kontrarata e datës 3 shkurt 2009, e vërtetuar para Gjykatës Komunale në Podujevë Vr. Nr. 164/09 dhe Çertifikatën e të Drejtave Pronësore të lëshuar nga Zyra Kadastrale e Komunës së Podujevës UL-71712061-00011 e datës 29 gusht 2008. Sipas tij vendimi është marrë duke u bazuar në gjendjen e vërtetuar gabimisht dhe jo të plotë faktike. Nga këto prova ligjore valide, rezulton se ai ka fituar të drejtën e pronësisë në këtë palujtshmëri nga pronari i saj, R.A.K., ndërsa ky i fundit më vonë e ka blerë këtë palujtshmëri nga M.G., R.D. and Z.D. mbi bazën e kontratës së shitjes së vërtetuar Vr.nr.2151/2008, me datë 23 dhjetor 2008, në Gjykatën Komunale të Podujevës.

Me 21 shtator 2011, I.D., është përgjegjur në ankesë, duke e konfirmuar deklaratën e ankuesit, duke shtuar se ngastra kadastrale 614/1 me sipërfaqe prej 0.45.41 ha, në vendin e quajtur “rruga iznad reke—obrandja”, zona kadastrale Peran, i është shitur me 22 dhjetor 2008 R.A.K. dhe shuma është paguar në tërësi.

Arsyetimi ligjor

Ankesa është e bazuar. Lënda bie jashtë jurisdiksionit të KKPK-ës.

Për të qenë një kërkesë e vlefshme, paraqitësi i saj ose bartësi i së drejtës pronësore, siq mund të jetë rasti, duhet të vërtetoj se ai ose ajo ka pasur të drejtën e pronësisë ose të drejtën e shfytëzimit në pronën e kërkuar, dhe që ai ose ajo nuk është në gjendje të ushtroj të drejtën e tij ose të saj për shkak të rrethanave që janë të lidhura drejtëpërsëdrejti ose që rrjedhin nga konflikti i armatosur i ngjarë në Kosovë midis 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999 (shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-079). Sido që të jetë, pala përgjegjëse në ankesë nuk ka provuar se ai ose paardhësi i tij ligjor nuk ishte në gjendje të ushtronte të drejtën e tij pronësore për shkak të rrethanave që janë të lidhura ose që rrjedhin nga konflikti i armatosur i ngjarë në Kosovë midis 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. Përkundrazi, ai ka konfirmuar deklaratën e ankuesit se prona i ishte shitur pas konfliktit R.K., që do të thotë se humbja e pronës nuk ishte për shkak të konfliktit por për shkak të shitjes.

Gjithashtu, nga shkresat e lëndës rezulton se: Me kontratën e shitjes së palujtshmërisë e vërtetuar Vr.nr.2151/2008, me datë 23 dhjetor 2008, nga Gjykata Komunale në Podujevë, R.K. kishte blerë palujtshmërinë e cila ishte objekt i kërkesës së parashtruar nga ana e paraqitësit të kërkesës, nga shitësit M.G., R.D. dhe Z.D., të cilët mbi bazën e Çertifikatës së të Drejtave Pronësore Mbi Palujtshmërinë UL-71712061-0001, e lëshuar me datë 29 gusht 2008 nga Zyra Kadastrale e Komunës e Podujevës, ishin pronarë. Për më shumë, ankuesi, sipas kontratës valide, të ligjshme dhe të vërtetuar Vr.nr.164/09 në Gjykatën Komunale të Podujevës me datë 3 shkurt 2009, kishte blerë palujtshmërinë nga R.A.K., dhe kjo gjithashtu është konfirmuar nga paraqitësi i kërkesës, i cili bile thekson që kontrata është përmbushur.

Duke pasur për bazë faktin se ankuesi e ka fituar palujtshmërinë me kontratën e ligjshme, valide dhe të vërtetuar Vr.nr.164/09 në Gjykatën Komunale të Podujevës me datë 3 shkurt 2009, dhe se paraqitësi i kërkesës ka pranuar se palujtshmërija është shitur dhe kontrata është përmbushur nga R.A.K. me 22 dhjetor 2008, humbja e pronës nuk ka të bëjë me rrethanat që janë të lidhura drejtëpërsëdrejti ose që rrjedhin nga konflikti i armatosur i ngjarë në Kosovë midis 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999, ashtu siq është përcaktuar me nenin 3.1 nënparagrafi a dhe b i Rregullores së UNMIK-ut 2006/5, e amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-079 të Republikës së Kosovës. Prandaj,

vendimi i ankimuar për sa i përket lëndës KPA39215 është anuluar dhe kërkesa është hedhë poshtë pasi që nuk bie në jurisdiksionin e KKPK-ës

Shpenzimet e procedurës:

Sipas Nenit 8.4 të Urdhëzimit Administrative 2007/5 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës pranë Sekretariatit Ekzekutiv ose Komisionit. Megjithatë, ky lirim nuk parashihet për procedurën pranë Gjykatës Supreme. Si rezultat i kësaj, zbatohet regjimi i rregullt i taksave gjyqësore i përcaktuar me Ligjin mbi taksën gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së nr. 3, tetor 1987) dhe me UA Nr. 2008/02 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës lidhur me unifikimin e taksave gjyqësore, edhe për procedurën pranë Gjykatës Supreme.

Kështu, në këtë procedurë të apelit zbatohen këto shpenzime gjyqësore:

- Tarifa nga taksa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (Neni 10.11 i UA nr. 2008/2): € 30
- Tarifa nga taksa gjyqësore për nxjerrjen e aktgjykimit (Nenet 10.15 dhe 10.21 të UA nr. 2008/2), duke marrë parasysh taksën më të lartë për aktvendimin e hedhjes së padisë që është € 30.

Këto shpenzime gjyqësore i bart pala përgjegjëse në ankesë e cila e humb rastin.

Sipas Nenit 46 të Ligjit mbi shpenzimet gjyqësore, afati për pagesën e shpenzimeve nga personi që banon jashtë vendit nuk mund të jetë më pak sesa 30 ditë dhe jo më shumë sesa 90 ditë. Gjykata Supreme vendos që në këtë rast, shpenzimet gjyqësore të paguhen nga parashtruesi i kërkesës në afat prej 90 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit.

Udhëzim juridik

Sipas Nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50, i amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet me mjete të rregullta dhe ato jashtëzakonshme juridike.

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Elka Ermenkova-Filcheva, Gjyqtare

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Philip Drake, Shef i Shkrimores pranë Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX